

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-042/13

**Prishtinë,
31 janar 2013**

Në çështjen juridike të:

B.U.

Komuna e Vitisë

Pala ankuese

kundër

B.S.

Serbi

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Willem Brower dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/92/2010 (lënda është regjistruar në AKP me numrin 07936), të datës 28 tetor 2010, pas shqyrtimit të mbajtur më 31 janar 2014, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Është e bazuar ankesa e B. U.
2. Anulohet vendimi KPCC KPCC/D/A/92/2010 i datës 28 tetor 2010 për sa i përket lëndës KPA 07936 për shkak të mungesës së juridiksionit.
3. Hedhet si e palejueshme kërkesa e B. S.

Përmbledhja e çështjeve procedurale:

1. Më 9 janar 2007, B. S. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar vërtetimin e së drejtës së tij pronësore ndaj një ngastre të tokës në Begracë, Kaçanik, ngastra numër 137 me sipërfaqe prej 0.15.28 ha (këtej e tutje: ngastra).
2. KKPK-ja në vendimin e datës 28 tetor 2010 ka gjetur se kërkesa ishte e bazuar dhe ka vendosur që B.S. kishte dëshmuar se ishte pronar i 5/18 të ngastrës.
3. Dosja e lëndës nuk përmban ndonjë informacion se a i ishte dorëzuar vendimi palës ankuese, e nëse po kur.
4. Pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së më 26 dhjetor 2012.
5. Ankesa i ishte dorëzuar B. S. më 22 korrik 2013. Bratislav Stojanović nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Përmbledhja e çështjeve faktike:

6. Kolegji i Apelit i merr si fakte të vërtetuara nga KKPK-ja dhe të pa-kontestuar nga palët ose përndryshe të dëshmuara të pavërteta këto çështje:
7. Sipas certifikatës së vdekjes, V. S. kishte vdekur më 29 nëntor 2005. Certifikata ishte lëshuar nga komuna e Kragujevcit, Serbi.
8. Në aktgjykimin e Gjykatës Komonale të Kragujevcit me numër O-497/06 të 30 marsit 2006, ishte konfirmuar se prona e V. S. përbëhej nga disa ngastra të tokës, ndër të cilat edhe ngastra 137, arë me sipërfaqe prej 0.15.28 ha.
9. Sipas aktgjykimit të njëjtë B. S. së bashku me vëllezërit e tij: V. S. dhe S. S., e kishin trashëguar pronën. B. 5/18, V. 5/18 dhe S. 8/18 të pasurisë.
10. Më 4 tetor 2011, B, V and S kanë nënshkruar një kontratë shitblerjeje me O. T. në të cilën (mes ngastrave tjera të tokës), ngastra 137 i ishte shitur O. T. Kontrata është pjesë e dosjes së lëndës.

Arsyetim ligjor:

Pozicionet e palëve:

Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që të vërtetojë se ai është pronar i ligjshëm i ngastrës.

Juridiksioni (sipas detyrës zyrtare):

11. Pala ankuese pohon se e kishte blerë ngastrën 137 më 28 mars 1997 nga V. S. Për të mbështetur deklaratën e tij, pala ankuese ka paraqitur një kopje të kontratës së shitblerjes të lidhur më 28 mars 1997.
12. Në këtë kontratë, shitësi V. S. ia shet ngastrën e tokës palës ankuese prej 12 ha, që gjendet në Kosum ZK Kaçanik. Kontrata është nënshkruar nga pala ankuese, nga V. S. si shitës dhe tre dëshmitarë: I.I., A. M.dhe V. S.
13. Pala ankuese më tej ka paraqitur një kopje të faturës të lëshuar për pagesën (e parë) më 30 mars 1997 në shumën prej 6.000 DM, e nënshkruar nga pala ankuese dhe V. S.
14. Më 26 qershor 2006, Gjykata Komunale në Kaçanik kishte vendosur për padinë e palës ankuese kundër V. S. dhe V. S.. Në vendimin nr. C 7/03, Gjykata Komunale në Kaçanik kishte vendosur se pala ankuese është pronar i dy ngastrave: 137 në vendin e quajtur Kosum Raga, arë e klasës 5 me sipërfaqe prej 0.15.28 ha, e regjistruar në fletën poseduese nr. 206 ZK Begracë, dhe 138 në vendin e quajtur Kosum Shoko Bara, arë e klasës 5 me sipërfaqe prej 0.14.53 ha, e regjistruar në fletën poseduese nr. 206 ZK Begrace.
15. Gjykata Komunale në Kaçanik në arsyetimin e saj ka vërtetuar se pala ankuese në fakt e kishte blerë ngastrën 137 (dhe 138) nga V. S. më 28 mars 1997.
16. Për aq sa Gjykata Supreme mund të vërej në këtë vendim të Gjykatës Komunale të Kaçanikut, kontrata e shitblerjes si dhe fletëpagesa nuk janë paraqitur në KKPK e as si pjesë e dosjes së lëndës e as si çështja pranë KKPK-së. Në fakt, kërkesa në KKPK ishte e pakontestueshme.
17. Prandaj, Gjykata Supreme konkludon se e drejta pronsore e palës ankuese pwr ngastrën 137 që nga 28 marsi 1997, tashmë ishte vërtetuar nga një gjyata komunale, dhe se KKPK-ja gjatë marrjes së vendimit nuk ka qenë në dijeni të të gjitha fakteve lidhur më këtë lëndë.
18. Informatat lidhur me shitjen e ngastrës 137 tek pala ankuese në vitin 1997 dhe vendimin për këtë çështje nga Gjykata Komunale e Kaçanikut duhet të konsiderohen si fakte të reja dhe prova të reja siç parashihet me nenin 12.11 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

19. Megjithatë, Gjykata Supreme do t'i pranojë këto prova dhe nuk do të kthejë lëndën në KKPK për rishqyrtim. Rishqyrtimi do të mund vetëm të shpinte në konkludimin se pronësia është vërtetuar përfundimisht nga Gjykata Komonale e Kaçanikut me vendimin e saj të lartpërmendur. Vendimi i mëvonshëm i Gjykatës Komonale të Kragujevcit për trashëgiminë e Vidosav Stojanovic duket qartë se është marrë pa konsideruar këtë informacion.
20. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të Komisionit për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon pronësinë mbi pronën por edhe që ai apo ajo tani nuk është në gjendje të ushtroj të drejtat ndaj asaj prone për shkak të rrethanave që direkt ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.
21. E lartcekura tregon se, gjatë paraqitjes së kërkesës, paraqitësi i kërkesës B. S. nuk ishte e as nuk kishte qenë pronar i ligjshëm i ngastrës 137. Ky status nuk ishte i ndërlidhur apo rezultonte drejtpërsëdrejti nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999. Kjo për faktin se babai i tij V ia kishte shitur ngastrën 137 palës ankuese në vitin 1997.
22. Prandaj, lënda është jashtë juridiksionit të AKP/KKPK-së.

Konkludim

23. Duke marrë parasysh atë që u cek më lartë, Gjykata Supreme sipas detyrës zyrtare ka ardhur në konkludim se vendimi i KKPK-së duhet të anulohet për shkak të mungesës së juridiksionit, ndërsa ankesa e palës ankuese duhet të hedhet poshtë.
24. Nga sa u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

25. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Holger Engelmann, Referent i EULEX-it